



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
SHOQËRIA RAJONALE E UJËSJELLËS KANALIZIME VLORE SH.A

Nr._____, Prot.

Vlorë, më _____.____.2026

Shtojca 13.

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor]

FORMULARI I NJOFTIMIT TË FITUESIT NË PËRFUNDIM TË AFATEVE TË
ANKIMIT

Data: 09.09.2026

Drejtuar: Operatorit ekonomik **VALONA KONSTRUKSION**

(Adresa: Lagjja Uji i Ftohte, ne perendim te rruges Vlore-Orikum , ne kufi me
Rezidencen Qeveritare)

& APIS CONSTRUCTION

(Adresa: Njesia Bashkiake Nr.4 Kodi Zip 1007 , Rruga Aleksander Moisiu ,
Ndertesa 117, Zona kadastrale Nr.8130,Tirane R)

& NDREGJONI

(Adresa: Njesia Bashkiake Nr. 8, Rruga Sule Bega, Ndertesa Nr. 32, Hyrja 8)

Tipi i Kontratës: **Punë**

Lloji i Procedurës së prokurimit: **Procedurë e hapur**

Numri i procedurës / referenca e Lotit: **Ref-93729-07-16-2026**

Përshkrimi i shkurtër i kontratës: **Objekti:** “Ndërtim rrjeti shpërndarës ujësjellësi për fshatin Tragjas dhe rehabilitim dhe vënie në funksion të KUZ, fshati Tragjas” **Kohe zgjatja e Kontrates:** 12 (dymbëdhjetë) muaj

Data e Publikimit në SPE të Njoftimit të Fituesit nga i cili nisin afatet e ankimit/Njoftimit të anulimit nga i cili nisin afatet e ankimit: **31.08.2026**

Data e Publikimit në Buletin e Njoftimeve Publike të Njoftimit të Fituesit nga i cili nisin afatet e ankimit /Njoftimit të Anulimit nga i cili nisin afatet e ankimit **Buletini Nr. 55 datë 31 Gusht 2026**

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit:

oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar ne kosto ☒ X

oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në çmim ☐

Me anë të këtij Njoftimi ju informojmë se, në këtë procedurë kanë marrë pjesë Ofertuesit e mëposhtëm me këto vlera përkatëse të ofruara:

1. VALONA KONSTRUKSION	K26330202E
& APIS CONSTRUCTION	L41513008A
& NDREGJONI	K31329048I

Emri i plotë i shoqërisë

Numri i NIPT-t

Vlera: 148,050,000 (njëqind e dyzet e tetë milion e pesëdhjetë mijë) **Lekë Pa TVSH**
(e shprehur në shifra dhe fjalë)

Totali i pikëve të marra **279 Pikë**

2. IDEAL CONSTRUCTION AND PROJECTION (I.C.P)	L91310511L
& LIQENI VII	K01730502W

Emri i plotë i shoqërisë

Numri i NIPT-t

Vlera: 155,015,961.57 (njëqind e pesëdhjetë e pesë milion e pesëmbëdhjetë mijë e nëntëqind e gjashtëdhjetë e një pikë pesëdhjetë e shtatë) **Lekë Pa TVSH**
(e shprehur në shifra dhe fjalë)

Totali i pikëve të marra **0 Pikë**

Nga pjesëmarrësit janë skualifikuar Ofertuesit e mëposhtëm:

1. IDEAL CONSTRUCTION AND PROJECTION (I.C.P)	L91310511L
& LIQENI VII	K01730502W

Emri i plotë i shoqërisë

Numri i NIPT-t

Vlera: 155,015,961.57 (njëqind e pesëdhjetë e pesë milion e pesëmbëdhjetë mijë e nëntëqind e gjashtëdhjetë e një pikë pesëdhjetë e shtatë) **Lekë Pa TVSH**
(e shprehur në shifra dhe fjalë)

Totali i pikëve të marra **0 Pikë**

1. Bashkimi i operatorëve ekonomik shoqëria “IDEAL CONSTRUCTION AND PROJECTION (I.C.P) shpk me NIPT L91310511L, me adresë Durrës Lagjia nr.18, Rruga Aleksandër Goga, Pallati 788, shk.1, k.1, Ap.2, pasuria numër 29/70+1-211, zona kadastrale 8511 dhe shoqëria “LIQENI VII” shpk me NIPT K01730502E, me adresë Lagjia nr.14, Shkozet, Durrës, me ofertë ekonomike 155,015,961.57 (njëqind e pesëdhjetë e pesë milion e pesëmbëdhjetë mijë e nëntëqind e gjashtëdhjetë e një pikë pesëdhjetë e shtatë) lek pa tvsh.

Në vlerësim të dokumentacionit të paraqitur nga bashkimi i operatorëve ekonomik për procedurën e prokurimit objekt vlerësimi rezulton se operatorët ekonomik kë plotësim të pikës 2.3.5 të kriterëve të vecanata të kualifikimit, konkretisht përsa i përket pikës së makineri pajiseve të kërkuar operatorët kanë paraqitur formularin përmbledhës të vetdeklarimit ku bazuar në legjislacionin për prokurimin public, si më poshtë:

Në pikat 1 dhe 2 të nenit 82 “Formulari përmbledhës i vetdeklarimit”, të ligjit Nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” përcaktohet se:

“1. Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoritetet ose entet kontraktore pranojnë si provë paraprake në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetdeklarimit, sipas parashikimeve të këtij

ligji. Përmbajtja e këtij formulari përcaktohet në rregullat e prokurimit publik. Kur autoriteti ose enti kontraktor mund t'i marrë dokumentet mbështetëse duke u futur direkt në një bazë të aksesueshme të dhënash shtetërore, në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit përcaktohet edhe informacioni që kërkohet për këtë qëllim, siç është adresa në internet e bazës të të dhënave, çdo e dhënë identifikimi dhe, sipas rastit, në deklaratën e nevojshme për dhënien e pëlqimit. Operatorët ekonomikë mund të përdorin një formular vetëdeklarimi që është përdorur gjatë një procedure prokurimi të mëparshme, nëse informacioni që ajo përmban vazhdon të jetë i saktë dhe i vlefshëm.

2. Në çdo kohë gjatë procedurës, autoriteti ose enti kontraktor mund t'u kërkojë ofertuesve dhe kandidatëve sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime, kur kjo është e nevojshme për të garantuar zbatimin korrekt të procedurës. Ndërsa në nenin 92/3 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” përcaktohet se: “3. Autoriteti ose enti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 38 të këtij ligji...”.

Në nenin 26 “Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit”, pikat 1, 2, 3, 6 dhe 7 të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se: “Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoriteti/enti kontraktor pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të LPP-së, dhe në këto rregulla.

2. Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit përmban informacion dhe deklarin, si më poshtë vijon:

- a) operatori ekonomik është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin ose sipas legjislacionit të posaçëm, në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv;
- b) operatori ekonomik nuk është dënuar për asnjë nga veprat penale, të parashikuara në pikën 1, të nenit 76, të LPP-së;
- c) personi/at në cilësinë e anëtarit të organit administrativ, drejtuesit ose mbikëqyrësit, aksionerit ose ortakut, ose që ka kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda operatorit ekonomik, nuk është ose ka qenë i dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për asnjë nga veprat penale, të përcaktuara në pikën 1, të nenit 76, të LPP-së;
- ç) operatori ekonomik nuk është dënuar me vendim të gjykatës së formës së prerë, për vepra që lidhen me veprimtarinë profesionale;
- d) operatori ekonomik nuk është në proces falimentimi;
- dh) operatori ekonomik ka paguar të gjitha detyrimet për pagimin e taksave dhe tatimeve 1 të kontributeve të sigurimeve shoqërore, sipas parashikimeve të pikës 2, të nenit 76, të LPP-së;
- e) operatori ekonomik ka shlyer të gjitha detyrimet e maturuara të energjisë elektrike, dhe përmbush kërkesat që rrjedhin nga legjislacioni i fushës në fuqi. Ky informacion kërkohet për operatorët ekonomikë, të cilët ushtrojnë veprimtarinë në territorin e Republikës së Shqipërisë;
- ë) operatori ekonomik nuk ndodhet në kushtet e konfliktit të interesit, sipas legjislacionit në fuqi;
- f) operatori ekonomik ushtron aktivitetin në zbatim të kërkesave ligjore të legjislacionit mjedisor, social dhe të punës;
- g) operatori ekonomik ka paraqitur ofertë të pavarur, sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi;
- gj) operatori ekonomik përmbush specifikimet teknike, sipas kërkesave të përcaktuara nga autoriteti/enti kontraktor;
- h) operatori ekonomik disponon fuqinë punëtore, të nevojshme për ekzekutimin e kontratës, sipas kërkesave të autoritetit/entit kontraktor (kur është rasti);
- i) operatori ekonomik disponon mjetet dhe makineritë e nevojshme për ekzekutimin e kontratës, sipas kërkesave të autoritetit/entit kontraktor, kur është rasti;
- j) informacion mbi subjektet, mbi kapacitetet e të cilave, operatori ekonomik do të mbështetet, nëse është rasti dhe nënkontraktorët e mundshëm, nëse është rasti;
- k) operatori ekonomik ushtron aktivitetin konform kërkesave të legjislacionit në fuqi.

3. Informacioni i pasqyruar në formularin e vetëdeklarimit, i cili gjendet në një bazë të dhënash, ku autoriteti/enti kontraktor mund të aksesojë direkt këtë informacion dhe /ose dokumentin, duhet të shoqërohet me adresën përkatëse për këtë bazë të dhënash.

4. Për përmbushjen e detyrimit sipas këtij neni, operatorët ekonomikë mund të përdorin një

formular vetëdeklarimi që është përdorur gjatë një procedure prokurimi të mëparshme, nëse informacioni që ajo përmban vazhdon të jetë i saktë dhe i vlefshëm.

5. Operatorëve ekonomikë nuk u kërkohet të dorëzojnë dokumente mbështetëse, kur autoriteti ose enti kontraktor që ka dhënë kontratën ose ka lidhur marrëveshjen kuadër, i ka këto dokumente.

6. Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuar me origjinalin.

Autoriteti/enti kontraktor pranon një dokument të lëshuar nga i njëjti institucion ose palë e tretë dhe që ka të njëjtin informacion me atë të paraqiturnë procedurën e zhvilluar në mënyrë elektronike.

Operatorët ekonomikë të huaj duhet të paraqesin dokumentet në formën e kërkuar nga legjislacioni në fuqi për njohjen e dokumentacionit të lëshuar në një shtet të huaj. Për dokumentet që nuk lëshohen në vendin e origjinës, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë këtë fakt, përndryshe dokumentacioni do të konsiderohet i paparaqitur.

7. Në çdo rast, autoriteti/enti kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik si më sipër, ose t’i kërkojë operatorit sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime.

III.2.8. Në nenin 39, pika 4 dhe gërma “d” e pikës 6 të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, parashikohet shprehimisht se: “4. Kërkesat e veçanta të kualifikimit duhet të përfshijnë të gjitha kriteret specifike në përputhje me nenin 77, të LPP-së. Kriteret duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës. Në çdo rast, autoriteti ose enti kontraktor duhet të përcaktojë dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve.

6. Për të provuar përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti/enti kontraktor kërkon:

d) mjetet e pajisjet teknike, të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.[....]”

Në zbatim të legjislacionit të prokurimit publik autoritetet kontraktor pranojnë si provë paraprake për të vërtetuar disponueshmërinë e kapaciteteve të operatorëve ekonomik në një procedurë prokurimi.

Nga verifikimi rezulton se ky operator nuk plotëson makinri paisjet e kërkuara për realizimin e kontratës objekt prokurimi si më poshtë mungojnë:

2 kamicioncina 3.5 -5 ton

1 kamion me vinc 3.5 -7 ton

1 eskavator me goma 0.25 m3

1 Minieskavator MT (mjet teknologjik me targa)

4 Dumper me kapacitet mbajtes mbi 25 ton

2 Autobetonierë kantieri 2-3 m3 MT (mjet teknologjik me targa)

1 Autobot per pastrim kanalesh (ujra te zeza)

2 Vibrator betoni

1 matrapik

1 elektrosaldatrice

2 kapeze per lidhje hekuri

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave për shkak të ekonomicitetit procedural ka vlerësuar të panevojshëm vijimin e verifikimit të dokumentacionit të operatorit ekonomik, duke qënë se përsëri statusi juridik i këtij operatori do të mbetet i s’kualifikuar.

Bazuar në Nenin 92 paragrafi 3 të Ligjit Nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, të ndryshuar me Ligjin Nr.16 datë 08.02.2024 ku parashikohet: “Autoriteti ose enti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat

dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 38 të këtij ligji”, Komisioni i Vlerësimit të Ofertave pranë Autoritetit Kontraktor bëri s’kualifikimin e bashkimit të operatorëve ekonomik shoqëria “IDEAL CONSTRUCTION AND PROJECTION (I.C.P) shpk me NIPT L91310511Ldhe shoqëria “LIQENI VII” shpk me NIPT K01730502Ë

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë **B.O.E VALONA KONSTRUKSION** me NIPT **K26330202E** me adrese: Lagjia Uji i Ftohte, ne perendim te rruges Vlore-Orikum , ne kufi me Rezidencen Qeveritare, & **APIS CONSTRUCTION** me NIPT **L41513008A** me adrese: Njesia Bashkiake Nr.4 Kodi Zip 1007 , Rruga Aleksander Moisiu, Ndertesa 117, Zona kadastrale Nr.8130,Tirane R, & **NDREGJONI** me NIPT **K31329048I** me adrese: Njesia Bashkiake Nr. 8, Rruga Sule Bega, Ndertesa Nr. 32, Hyrja 8, se, oferta e paraqitur, me një vlerë të përgjithshme prej : **148,050,000 (njëqind e dyzet e tetë milion e pesëdhjetë mijë) Lekë Pa TVSH** /pikët totale të marra **279 Pikë** , është identifikuar si oferta fituese.

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqisni pranë **Shoqërisë Rajonale Ujësjiellës Kanalizime Vlorë** me adresë: **Lagja “Kushtrimi”, Rruga “Arkobaleno”** ,me person përgjegjës për prokurimin me nr. Cel 0688557485, sigurimin e kontratës, siç parashikohet në dokumentat e tenderit, brenda 5(pesë) ditëve nga dita e marrjes/publikimit të këtij njoftimi.

Nese nuk dorëzoni sigurimin e kontratës brenda afatit përfundimtar të parashikuar në dokumentet e tenderit, apo tërhiqeni nga nënshkrimi i kontratës, do t’ju konfiskohet sigurimi i ofertës suaj dhe kontrata do t’i akordohet ofertuesit vijues në klasifikimin përfundimtar, oferta e të cilit është dorëzuar me një vlerë të përgjithshme prej *[vlera përkatëse e shprehur në fjalë dhe shifra]*, siç parashikohet në nenin 83 të Ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, të ndryshuar.

Ankesa pas Njoftimit të Fituesit, nga i cili nisin afatet e ankimit /Njoftimit të Anulimit, nga i cili nisin afatet e ankimit

PO ☐ JO ☒

Nëse Po (Nr.____ Datë____ i vendimit përfundimtar për shqyrtimin e ankesës, të dhënë nga Komisioni i Prokurimit Publik)

TITULLARI I AUTORITETIT KONTRAKTOR